



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 shtator 2015
Nr. ref.: RK 840/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin nr. KI36/15

Parashtrues

Sahit Ninaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 378/2014, të 29 dhjetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sahit Ninaj, me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, i 29 dhjetorit 2014, me të cilin kërkesa e parashtruesit për revizion kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 611/2014 të 25 gushtit 2014, ishte hedhur poshtë si i palejuar. Parashtruesi pohon të ketë pranuar aktvendimin e kontestuar më 30 janar 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 378/2014, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI36/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI36/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 28 prill 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 7 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Mbështetur në faktet e përshkruara nga parashtruesi në kërkesën drejtuar Gjykatës, parashtruesi, në një datë të pasaktësuar, i ishte drejtuar Komunës së Prizrenit me kërkesën që kjo e fundit t'ia sigurojë dhe t'ia dorëzojë atij një truall nga fondi i paluajtshmërive të Komunës, si kompensim për shtëpinë e tij të djegur gjatë luftës. Parashtruesi më tej pohon se lokacioni ku ndodhej shtëpia e

- tij ishte i minuar. Sipas parashtruesit, Komuna e Prizrenit nuk i është përgjigjur asnjëherë kërkesës së tij.
10. Në vijim të kërkesës së pohuar në paragrafin paraprak, më 22 prill 2009, parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prizren, nëpërmjet të cilës kishte kërkuar që Komuna e Prizrenit t'i kompensojë një paluajtshmëri në sipërfaqe prej 2 ari për ndërtimin e shtëpisë.
 11. Më 18 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/09) kishte vendosur të pezullonte procedurën me arsyetimin se palë ndërgjyqëse në cilësinë e të paditurës ishte Komuna e Prizrenit dhe, si rrjedhojë, për kërkesat kundër autoritetit publik me anë të së cilës kërkohet kompensimi monetar ose kompensim tjetër, parashtruesi duhej të siguronte një kopje të shkresave për Ministrinë e Drejtësisë.
 12. Si rezultat i aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prizren, parashtruesi kishte njoftuar Ministrinë e Drejtësisë lidhur me padinë e tij.
 13. Më 10 maj 2011, parashtruesi i kërkesës, në urgjencën e tij drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren, i kishte kërkuar Gjykatës Komunale të caktojë seancë për shqyrtimin kryesor dhe njëkohësisht kishte deklaruar që vlera e kontestit është 3.100 euro, dhe jo 50 euro, siç e kishte cekur ai në padinë e tij të parashtruar më 22 prill 2009.
 14. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/09) kishte konstatuar që padia e parashtruar ishte e mangët, sepse nuk i përmbante elementet e domosdoshme të padisë, ashtu siç kërkohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK). Si rrjedhojë, Gjykata Themelore kishte kthyer padinë e parashtruesit për plotësim dhe për përmirësim, duke kërkuar nga parashtruesi që në afat prej 3 (tri) ditësh të saktësojë mënyrën e kompensimit për paluajtshmërinë për të cilën kërkohet kompensimi dhe të identifikojë paluajtshmërinë ku kishte qenë shtëpia e parashtruesit.
 15. Gjykata Themelore, ndër të tjera, kishte thënë që nëse padia nuk plotësohet dhe nëse nuk korrigjohet ashtu siç është kërkuar me aktvendimin e saj, atëherë padia do të hidhet poshtë.
 16. Si rezultat i aktvendimit të lartpërmendur, më 23 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatën Themelore parashtrësën me plotësimin e padisë. Lidhur me mënyrën e kompensimit të paluajtshmërisë, parashtruesi kishte kërkuar që si kompensim për shtëpinë e djegur të tij, Komuna e Prizrenit t'ia sigurojë atij një truall nga fondi i paluajtshmërive të Komunës, duke mos identifikuar paluajtshmërinë, të cilën e kërkonte si kompensim. Ndërsa lidhur me identifikimin e paluajtshmërisë, ku kishte qenë shtëpia e tij e djegur, parashtruesi kishte deklaruar që kjo paluajtshmëri mund të identifikohet në bazë të ekspertizës.
 17. Më 26 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi C. nr. 280/2009) hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit.

18. Në aktvendimin e saj, Gjykata Themelore në Prizren vlerësoi se, përkundër parashtrësës së paraqitur nga parashtruesi më 23 dhjetor 2013, parashtruesi nuk e kishte përmirësuar dhe nuk e kishte plotësuar padinë ashtu siç ishte kërkuar me aktvendimin e 12 dhjetorit 2013. Sa i përket mënyrës së kompensimit të paluajtshmërisë, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi nuk kishte saktësuar mënyrën e kompensimit të paluajtshmërisë dhe nuk kishte identifikuar paluajtshmërinë, apo ngastrën për të cilën kërkonte kompensim.
19. Më 22 janar 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të procedurës kontestimore, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 25 gusht 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ca. nr. 611/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C. nr. 280/09, të 26 dhjetorit 2013.
21. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se parashtruesi nuk e ka saktësuar padinë e tij ashtu siç ishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit, pretendimet e parashtruesit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për zbatim të gabuar të drejtës materiale ishin të pabazuara për arsye se Gjykata Themelore në Prizren nuk ishte lëshuar në vërtetimin e gjendjes faktike dhe nuk ka pasur mundësi të zbatojë të drejtën materiale, për arsye se Gjykata Themelore aktvendimin e saj e kishte nxjerrë në zbatim të dispozitave procedurale.
22. Më 9 tetor 2014, parashtruesi parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit.
23. Më 29 dhjetor 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. Nr. 378/2014) e hodhi poshtë kërkesën për revizion si të palejuar.
24. Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave të LPK-së, konstatoi se revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar, për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin parashtruesi e kishte cekur në kërkesëpadinë e tij, e cila vlerë nuk ishte ndryshuar as me parashtrësën për plotësimin e padisë së tij, është më e vogël se vlera e objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e ligjit të lartpërmendur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Ashtu siç është thënë më lart, parashtruesi pretendon se aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
26. Parashtruesi më tej pretendon që gjykatat e rregullta, me aktvendimet e tyre, kanë shkelur po ashtu të drejtën e tij të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, për arsye se padia e tij nuk ishte shqyrtuar fare.

27. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata që “të kthejë gjendjen e mëparshme para aktvendimeve, Rev. Nr. 378/2014 dt. 29. 12 2014, Ac. nr. 611/2014, dt. 25.08. 2014 dhe C. Nr, 280/2009 dt. 26.12.2013, sepse në një gjendje të tillë mund të shqyrtohet kërkesëpatria ime dhe të merret vendim meritor gjyqësor në Gjykatën Themelore në Prizren”.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Në kërkesën e tij, parashtruesi ndër të tjera pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për arsye se gjykatat e rregullta, duke hedhur poshtë padinë e tij si jo të plotë, si dhe duke hedhur poshtë kërkesën e tij për revizion si të palejuar, nuk e kanë shqyrtuar fare padinë e tij.

32. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prizren, pas kërkesës së saj për plotësimin dhe për saktësimin e padisë së parashtruar nga parashtruesi, kishte vendosur që padinë ta hedhë poshtë për arsye se padia nuk i përmbante elementet e domosdoshme të padisë ashtu siç kërkohet me dispozitat e LPK-së. Si rezultat i ankesës së parashtruesit kundër aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke

konstatuar se Gjykata Themelore në Prizren e kishte nxjerrë aktvendimin e saj duke zbatuar dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale.

33. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave përkatëse të së drejtës procedurale, kërkesën për revizion të parashtruesit e kishte hedhur poshtë si të palejuar për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin parashtruesi e kishte cekur në padinë e tij dhe e cila vlerë sipas Gjykatës Supreme nuk ishte ndryshuar as me parashtrësën për plotësimin e padisë së tij, është më e vogël se vlera e objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e LPK-së.
34. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon dhe nuk dëshmon se si ishin shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, në veçanti e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me kualifikimin ligjor të fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi ligjor i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.
36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
37. Gjykata më tej konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurave të përfunduara në gjykatat e rregullta, në veçanti në Gjykatën Supreme, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezótúr-Tiszazugi Vizgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin KI198/13, parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
38. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
39. Në fund, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).
40. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkeljen e

të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

41. Prandaj, kërkesa është qartazi e papabuzuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1), d) dhe (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi